



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 738/2 Prot.

Tiranë, më 21/05/2021

V E N D I M

Nr. 82 , Datë 21 /05 / 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.84 regj, datë 10.05.2021, të paraqitur nga ankuesi J.B, kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *aftësisë së kufizuar*. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi ka parashtruar se, ai është një qytetar i cili për shkak të sëmundjes që ka, shpesh herë paragjykohet, ofendohet dhe diskriminohet nga institucione të ndryshme kur paraqitet për të marrë shërbim pranë tyre.

Ankuesi shpjegon se rasti i fundit ka të bëjë me Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, e cila nuk i jep shërbimin që ka për detyrë t’i ofrojë si qytetar. Ankuesi pretendon se ai kërcënohet dhe i bëhet presion nga shtetasi Gj.R, një person sipas tij i njohur si kontigjent kriminal, dhe për këtë fakt ai ka telefonuar numrin 129, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ankuesi shprehet se, jo vetëm që nuk ka marrë përgjigje nga policia, por i kanë bllokuar edhe numrin. Më pas ankuesi deklaroi se ka telefonuar edhe drejtuesit e policisë, konkretisht Drejtuesin e Policisë Vendore Shkodër, i cili fillimisht i është përgjigjur, por më pas edhe ai i ka bllokuar numrin.

Ankuesi shprehet se ndihet i kërcënuar, ndërkohë që shërbimet policore nuk i ofrojnë shërbimin që ai kërkon si qytetar dhe nuk i marrin denoncimin. Sipas ankuesit e gjithë kjo sjellje vjen si rezultat i sëmundjes që ai ka dhe për këtë arsye ai diskriminohet duke mos i’u marrë për bazë shqetësimet që ka.

¹Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Ankuesi kërkon nga Komisioneri ndalimin e diskriminimit të tij dhe marrjen e shërbimit nga ana e policisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me *aftësinë e kufizuar* të pretenduar nga ankuesi, duke parashikuar në nenin 1, të tij si vijon: “***Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.***”

Neni 3, i ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, përcakton se: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, garantohej *ndaj çdo veprimi apo mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në datë 18.05.2021, ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit, një deklaratë nëpërmjet të cilës kërkon që çështja e tij të mbyllet dhe se heq dorë nga ankesa².

² Kërkesa për heqje dorë, është dërguar në rrugë elektronike nëpërmjet Zyrës Rajonale të Komisionerit në Shkodër.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Bazuar në nenin 90 “Përfundimi i procedurës administrative”, paragrafi 3, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.”

Bazuar në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, paragrafi 1, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga ankuesi J.B, i cili me anë të deklaratës së datës 18.05.2021 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 3, nenin 33 pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 90, pika 3 dhe 94, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 84 regjistri, datë 10.05.2021, të paraqitur nga ankuesi J.B kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.
1. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar

Fusha: Shërbime

Lloji i vendimit: Ndërprerje e procedurës për shkak të tërheqjes së ankesës